



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.92/2024

Prishtinë, më 19.6.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Albana Bytyçi, Fatmire Kollçaku, Nasuf Bejta, Ariana Musliu Shoshi, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Munguan: Arjeta Fejza, Drita Millaku dhe Labinotë Demi- Murtezi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Besarta Pllana-Kuvendi i Kosovës, Hysni Mehani-GP-LV, Medina Ismajli-Praktikante D+, Valbone Demaj-Kuvendi Komunal, Istog, Fjollë Haziri-KDI dhe Celal Ilyas-Kuvendi i Kosovës

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim në Komision lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
3. Shqyrtimi i peticioneve;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim në Komision lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë;

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit se sa i përket këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë është duke e bërë udhëzimin administrativ për lehtësimin e procedurave për aplikim. Deri më tani kanë qenë dy komisione vlerësuese, tash parashihet të jetë vetëm një komision, edhe kategorizimi i këtyre personave është një problem dhe për këtë kemi diskutuar disa herë, për këtë udhëzim administrativ, tha se propozon të diskutohet sërish me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Financave.

Fatmire Kollçaku, tha se për momentin ligji i rregullon vetëm kategorinë e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për zgjerimin e përfituesve dhe se dihet që ka kërkesa të mëdha edhe për shoqërues e përfitues të tjerë, por duhet me u ndryshua emri i ligjit. Por, meqenëse ka kërkesa të shumta, duhet ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe konkretisht zëvendësministri i Ministrisë së Financave, që merret me çështjen e pensioneve, apo zyrtarë të tjerë kompetent për të mësuar si është gjendja.

Ajo tha, se kjo ndërlihet edhe me peticionin e Sindikatës së ish- policëve të viteve të 90-ta dhe edhe këtë temë mund ta diskutojmë po në atë takim.

Sa i përket tryezës për shëndetin mendor, tha se kjo tryezë është shumë e qëlluar, në veçanti shikuar nga aspekti i respektimit të drejtave të personave që janë prekur me probleme të llojit të shëndetit mendor, në kuptimin e asaj sa respektohet dinjiteti i tyre, vullneti për trajtim dhe si trajtohen rastet akute.

Ajo njoftoi se Ministria e Punëve të Brendshme, është duke e hartuar strategjinë kombëtare për drogat, ministria e shëndetësisë t'na tregojë për strategjinë për shëndetin mendor, për Ligjin për shëndet mendor, dhe të fokusohemi në këtë temë në tryezën e datës 25 qershor.

Kryetarja, konstatoi që komisioni vendosi t'i ftojë në takim, përfaqësuesit kompetentë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, të mërkurën, më 3 korrik, në orën 11:00, në lidhje me udhëzimin administrativ për Komisionin mjekësorë, për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

3. Shqyrtimi i peticioneve

Kryetarja, konstatoi se komisioni vendosi që në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të adresohet edhe çështja e peticionit të Sindikatës së ish- policëve të viteve të 90-ta dhe të sindikatës së ish- punëtorëve të administratës viteve të 90-ta, lidhur me zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, lidhur me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, dhe të diskutohet me përfaqësues të ministrisë ditën kur janë të ftuar edhe për udhëzimin administrativ për Ligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, më 3 korrik 2024.

3. Të ndryshme.

Kryetarja, njoftoi komisionin lidhur me një takim që pati me disa persona të cilët janë të varur nga droga dhe me kërkesat që kishin parashtruar ata.

Kosova nuk ka qendër rehabilituese për këta persona dhe se është rritur numri i fëmijëve të prekur nga kjo dukuri në shkollat fillore dhe të mesme të vendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,
Kryetare e Komisionit